Barazia Gjinore dhe Diskriminimi në Organet e Emëruara të Pushtetit Vendor

Barazia mes grave dhe burrave përbën një të drejtë themelore për të gjithë. Ajo është një vlerë thelbësore për demokracinë në Shqipëri dhe për integrimin e saj në Bashkimin Europian. Me gjithë përpjekjet për ta trajtuar barazinë gjinore dhe përparimit të arritur në njohjen e saj formale, barazia e grave dhe burrave në jetën e përditshme ende nuk është një realitet. Ka shumë pak informacion në lidhje me përfaqësimin e gruas në organet e emëruara të pushtetit vendor. Ky studim përbën përqasjen e parë institucionale ndaj këtij fenomeni dhe për herë të parë do të prodhojë disa statistika në lidhje me raportet e përfaqësimit të gruas në organet e emëruara të pushtetit vendor. Synimi i këtij studimi është të pasqyrojë një tablo, në maksimumin e mundshëm, të konfigurimit gjinor në përbërjen e organeve të emëruara të pushtetit vendor dhe mbi bazën e analizës së kësaj statistike të mundësojë rekomandime për organet vendimmarrëse dhe politikëbërëse.

Bashki me më shumë se 1 administrator, me përfaqësuese gra në pozicionin e administratorit (korrik 2018)



Gra të emëruara drejtuese të institucioneve vendore në bashki (korrik 2018)



Kategorizimi i bashkive me më shumë se 1 administrator në Shoqëri Tregtare sipas përfaqësimit të grave



Gra të emëruara zëvendës Kryetare në bashki (Korrik 2018)



Çfarë parashikon ligji

Neni 15 i ligjit "Për barazinë gjinore" parashikon se përfaqësimi i barabartë gjinor në të gjitha organet e pushtetit legjislativ, ekzekutiv dhe gjyqësor dhe në institucionet e tjera publike arrihet kur sigurohet:

a) përfaqësim në masën mbi 30 për qind për secilën gjini, përfshirë edhe në organet e tyre drejtuese;

b) respektimi në mënyrë të njëjtë për secilën gjini i procedurave dhe kritereve të konkurrimit, gjatë emërimit në këto organe;

c) përfshirja mbi 30 për qind e secilës gjini në listën e kandidatëve për zgjedhjet në organet përfaqësuese vendore;

d) përfshirja jo më pak se 30 për qind e secilës gjini në listën e kandidatëve të paraqitur nga partitë politike për sistemin proporcional për zgjedhjet e Kuvendit të Republikës së Shqipërisë;

e) përfshirja mbi 30 për qind të secilës gjini në organet administruese të procesit të zgjedhjeve qendrore dhe vendore.

Rekomandime bazuar në studim dhe statistikat e paraqitura

a) Edhe pse është arritur një përparim domethënës, ende gruaja gjendet e papërfaqësuar në sektorin publik.

b) Dështimi për të përfshirë gruan në postet politike dhe administratën publike do të konsiderohet si "evidencë" e diskriminimit struktural ndaj gruas.

c) Është i nevojshëm ndryshimi i ligjit nr. 10221/2010 "Për mbrojtjen nga diskriminimi" duke e shtrirë kompetencën e mbikëqyrjes së Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi edhe në aspektin e barazisë gjinore.

d) Eshtë i nevojshëm parashikimi i një mekanizmi monitorues dhe sanksionues lidhur me ligjin "Për barazinë gjinore në shoqëri".

e) Është i nevojshëm ndryshimi në ligjin nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", me qëllim adresimin e kuotës gjinore prej 30 %, sipas parashikimeve të nenit 15 të ligit "Për barazinë gjinore në shoqëri".

f) Është e nevojshme marrja e masave ligjore dhe krijimi i një mekanizmi efikas që të garantojë përfaqësimin e gruas në rastet e rekrutimit të punonjësve në administratën publike vendore. Aktualisht ky mekanizëm mungon.

g) Legjislacioni për shërbimin civil duhet të ndryshohet me qëllim që të garantojë që jo më pak se 30 % e drejtuesve të administratës publike vendore të përfaqësohen nga gra.

h) Në të gjitha entet, shoqëritë tregtare, agjencitë, etj., që krjon pushteti vendor duhet të jetë e detyrueshme respektimi i kuotës gjinore të përbërjes së tyre.

i) Ndryshimet ligjore duhet të shoqërohen me fushata ndërgjegjësimi për të nxitur dhe zhvilluar barazinë e plotë gjinore.

j) Çdo bashki duhet të ketë evidenca të qarta të publikuara dhe të përditësuara në lidhje me çështjet e barazisë gjinore.

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi
Commissioner for Protection from Discrimination

UN WOMEN